



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA JURIDIKE

26518
Nr. _____ Prot

Shkodër, më 30.12.2025

VENDIM

438
Nr. _____ datë 30/12/2025

"PËR DELEGIM KOMPETENCE"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 "Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë"; ligjit nr.9936 .datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; ligjit nr.9920 dt. 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit 9632 date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, ligjit nr. 79/2017 "Për Sportin" i ndryshuar, ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr.9270 date 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" të ndryshuar, ligjit nr.8308 date 18.03.1998 "Për transportet rrugore" të ndryshuar; ligjit nr.93/2015 "Për Turizmin" të ndryshuar;

VENDOSA:

1. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkise Shkodër, Z. Rudin Beka me detyrë zëvendeskryetar bashkise Shkodër;

- Për nënshkrimin e çdo shkrese që ka të bëjë me institucionet publike, personat

juridik/fizik dhe individ për:

- Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik
- Drejtorinë e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit
- Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore

- Drejtorinë e Arsimit
 - Gjendjen Civile
 - Konfirmimin e adresave të qytetareve nga sistemi.
2. Zv/Kryetari nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
 3. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen duke filluar nga data 01.01.2026 dhe përfundojnë me datë 30.06.2026 ora 16:00.
 4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet z.Rudin Beka dhe administrata bashkisë Shkodër
 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëhere dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

KRYETAR

Benet BECI

